



Memorandum Mirëkuptimi (MM)



ndërmjet

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Zyra e GIZ në Shqipëri
Rr. "Asim Zeneli", 6/10
Tiranë, Shqipëri

– në vijim referuar si "GIZ" –

dhe

Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB)

Rruga "Jordan Misja",
Pallati 141/1, shkalla 1, kati 2, Tiranë

– në vijim referuar si "AKVMB" –

dhe

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV)

Rruga "Aleksandër Moisiu" Nr.82 - Tiranë - Shqipëri.

– në vijim referuar si "ISUV" –

dhe

Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT)

Rruga "Paisi Vodica" 1025 Kodër-Kamëz- Shqipëri.

– në vijim referuar si "UBT" –

- GIZ, AKVMB, ISUV dhe UBT në vijim referuar bashkërisht si "Partnerët" –



Implemented by



DUKE QENË SE

GIZ është një ndërmarrje në pronësi të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe ofron shërbime në mbarë botën në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar për zhvillim të qëndrueshëm dhe edukimit në nivel ndërkombëtar. Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) është pala kryesore porositëse, por ekziston dhe një bashkëpunim i ngushtë me sektorin privat, duke nxitur ndërveprimin e suksesshëm ndërmjet zhvillimit të politikave dhe tregtisë së jashtme. GIZ operon gjithashtu në emër të ministrive të tjera gjermane, të institucioneve të Bashkimit Evropian, të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe qeverive të vendeve të tjera.

GIZ Albania është aktiv që nga viti 1988 dhe zbaton projekte në tre fusha kyç, të tilla si zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, formimi dhe punësimi, klima dhe energjia, tranzicioni i drejtë, si dhe në fushën e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse.

Bashkëpunimi i përcaktuar në këtë MM do të realizohet nga ana e GIZ përmes projektit **Zhvillimi i Qëndrueshëm Rural (SRD)**, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Ky bashkëpunim do të kryhet në kuadër të SRD II, i cili është një program i zbatuar nga GIZ në emër të Qeverisë Gjermane dhe që bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim për periudhën 2023-2026. SRD punon me bizneset dhe me qeverinë për të rritur konkurrueshmërinë dhe të ardhurat në zonat rurale të Shqipërisë. SRD sjell risi me partnerët në fushën e bujqësisë dhe turizmin rural, i përfshin ato në treg dhe krijon një mjedis favorizues të konsoliduar. Projekti SRD ka në fokus sektorin e frutave, perimeve, bulmetit dhe të bimëve mjekësore në zinxhirin e vlerave në bujqësi, si dhe promovon veprimtaritë sportive në natyrë, agroturizmin dhe menaxhimin e destinacionit në turizmin rural. E gjitha kjo bëhet në kontekstin e anëtarësimit në BE, promovimit të zhvillimit ekologjik, nxitjes së digjitalizimit dhe rritjes së diversitetit.

DUKE QENË SE

AKVMB është krijuar sipas dispozitave të Ligjit nr. 10465 datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i cili parashikon krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve si person juridik publik që financohet nga buxheti i shtetit, në varësi të ministrit përgjegjës për veterinarinë, me seli në Tiranë.

Misioni i saj është që të garantojë mbrojtjen e shëndetit dhe të mirëqenies së kafshëve, mbrojtjen e shëndetit publik në Republikën e Shqipërisë nga sëmundjet zoonotike të transmetueshme nga kafshët, si dhe mbrojtjen e bimëve, nëpërmjet drejtimit të veprimtarisë së kontrollit zyrtar dhe veprimtarive të tjera veterinare brenda fushës së përgjegjësisë, dhe ofrimit të shërbimit të mbrojtjes së bimëve nga dëmtuesit dhe sëmundjet. Autoriteti shtetëror në fjalë ka përgjegjësinë që: a) të drejtojë shërbimin veterinar, brenda fushës së përgjegjësisë; b) të organizojë punën për kryerjen e kontroleve zyrtare dhe veprimtaritë e tjera veterinare; c) të organizojë punën për ofrimin e kontrollit dhe shërbimit të mbrojtjes së bimëve nga dëmtuesit.

AKVMB e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme; në nivel rajonal, nëpërmjet 4 (katër) drejtorive rajonale të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve në Tiranë, Elbasan, Vlorë, Shkodër dhe përmes njësive direkte të ofrimit të shërbimit veterinar.

AKVMB ka si mision të saj që të monitorojë sëmundjet e kafshëve dhe zoonozave, mbikëqyrjen e tregtimit dhe përdorimit të produkteve mjekësore veterinare dhe mirëqenien e kafshëve. Përgjegjësia e këtij institucioni shtrihet edhe në mbajtjen e përditësimin e regjistrave zyrtarë për



financed by **giz** Deutsche Entwicklungszusammenarbeit
German Development Cooperation GIZ GmbH



fermat dhe stabilimentet blegtorale, subjektet që tregtojnë kafshë, subjektet që prodhojnë, ruajnë dhe tregtojnë produkte embrionale, individët që transportojnë kafshë, produkte embrionale, nënprodukte me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor.

AKVMB monitoron qendrat e grumbullimit të kafshëve ose pikat karantinore, subjektet që prodhojnë ose tregtojnë produkte mjekësore veterinarë; vendet ku zbatohet praktika mjekësore veterinarë dhe mjekët veterinarë që punojnë atje. Institucioni është përgjegjës për ndjekjen e procesit në lidhje me personat që lejohen të kryejnë eksperimente me kafshë dhe zbatojnë procesin e identifikimit e të regjistrimit të kafshëve të fermave blegtorale, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.

AKVMB është përgjegjës për trajtimin, përdorimin dhe asgjësimin e nënprodukteve shtazore, jo për konsum njerëzor, si dhe për mbledhjen e karkasave dhe aktivitetet e lidhura me to. Misioni vijon me mbikëqyrjen e inspektimit të procesit të thërjes dhe mirëqenies së kafshëve në thertore; mbikëqyrjen edhe kontrollin e lëvizjes dhe tregtimit të kafshëve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe, ndër të tjera, lëshon certifikatat veterinarë lidhur me statusin shëndetësor të kafshëve.

DUKE QENË SE

ISUV është e vetmja qendër reference në Shqipëri, e cila është e Certifikuar kombëtarisht dhe ndërkombëtarisht për një sërë analizash. ISUV varet nga Ministria Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) dhe është përgjegjëse kryerjen e analizave laboratorike monitoruese dhe survejancës së situatës epidemiologjike të sëmundjeve infektive, zoonozave dhe kontaminanteve.

ISUV kryhen kontrole të produkteve ushqimore lëndë e parë dhe nënprodukteve, me origjinë shtazore, jo-shtazore, të ushqimeve të kafshëve, të cilat janë prodhuar në vend, importohen ose eksportohen.

ISUV ka si mision të zhvillojë, validojë dhe akreditojë metoda testimi për të gjitha hallkat e zinxhirit ushqimor dhe të bashkpunojë me efektivitet me laboratorët respektivë të referencës të BE-së, të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve (WAHO) dhe organizma ndërkombëtar si WHO, FAO dhe EFSA.

Në këtë kontekst ISUV është angazhuar të përmiresojë strukturën analitike drejt validimi dhe akreditimit të shërbimeve; të zgjidhë pasigurinë gjatë mbikëqyrjes së sëmundjeve të kafshëve, agjentëve zoonotike, rezistencës antimikrobike dhe të shpërthimeve të sëmundjeve në njerëz; të përmbush kushtet e përcaktuara në praktikën e mira laboratorike dhe standartet ISO.

DUKE QENË SE

UBT është themeluar në vitin 1951. Fillimisht, ai është quajtur "Instituti i Lartë Bujqësor". Ai ka marrë emrin aktual në vitin 1991. Është aktualisht institucioni i vetëm në Shqipëri për studimet universitare dhe pasuniversitare, kërkimin shkencor, formimin dhe zgjerimin e njohurive në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (Agronomi, Hortikulturë dhe Mbrojtja e Bimëve, Agrobiznes, Ekonomi dhe Politikë Agrare, Mjedisi dhe Burimet Natyrore, Teknologji Agroushqimore, Biznes Blegtoral, Menaxhim i Akuakulturës dhe Peshkimit, Inxhinieri Pyjore, Mjekësi Veterinarë etj.). Çdo vit, rreth 15 000 studentë nisin studimet në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Stafi aktual akademik përbëhet nga 55 profesorë, 48 profesorë të asociuar, 55 profesorë me gradën doktor, 13 pedagogë-lektorë dhe 64 asistentë.

MISIONI

Misioni i UBT është të edukojë shkencëtarë dhe profesionistë të lartë të të menduarit kritik, të kualifikuar për të udhëhequr zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe mjedisor në vend.

VIZIONI

Çdo ditë, ne ndjekim vizionin e Universitetit Bujqësor të Tiranës për t'u bërë një universitet kërkimor gjithnjë e më i njohur në vend dhe rajon, i hapur ndërkombëtarisht dhe i shkëlqyer, që kontribuon vazhdimisht dhe në mënyrë krijuese në cilësinë e jetës në vend.

PËR RRJEDHOJË, Partnerët bien dakord si më poshtë:

1. Qëllimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi

Partnerët bien dakord për këtë Memorandum Mirëkuptimi (MM) për të përcaktuar kushtet bazë sipas të cilave palët do të punojnë së bashku në kuadër të mandateve të tyre dhe do të bashkëpunojnë për zhvillimin dhe zbatimin e këtij projekti të përbashkët për të adresuar menjëherë shenjat e mastitit për parandalimin, diagnostikimin dhe kontrollin e kësaj sëmundjeje të zakonshme të gjedhit, përmes novacioneve të prezantuara dhe ruajtjes së shëndetit të tufës, duke garantuar prodhimin optimal të qumështit dhe reduktimin e humbjeve ekonomike.

Aktivitetet në kuadër të këtij projekti do të jenë:

- Vlerësimi i përhapjes së mastitit të gjedhit e qumështit në Shqipëri, si dhe rëndësia e parametrevë zooteknikë të tillë si ushqimi dhe kushtet e higjienës.
- Vlerësimi i formës mbizotëruese të mastitit klinik dhe nënklinik në Shqipëri.
- Zbatimi i Praktikave të Mira Veterinare të Parandalimit (PVT) dhe Praktikave të Mira Zooteknike (PMZ) për parandalimin e mastitit në fermat e gjedhëve të qumështit.
- Zhvillimi i një udhëzuesi këshillues (manual) për fermat në lidhje me parandalimin, diagnostikimin dhe procedurat më të mira veterinare dhe zooteknike për fermat e gjedhëve të qumështit.
- Trajnimi i veterinerëve nga drejtoritë rajonale, të cilët gjithashtu do të udhëzojnë fermerët e fermave të qumështit.

2. Fushat e bashkëpunimit dhe aktivitetet e përbashkëta

Partnerët synojnë që të bashkëpunojnë për fazat e ndryshme të projektit, si më poshtë:

Faza I. Vlerësimi i përhapjes së mastitit të formës klinike dhe nënklinike.

- 1.1. Testimi i fermave të gjedhit duke përdorur Testin Kalifornian të Mastitit (TKM).
- 1.2. Identifikimi i agjentëve bakterialë të pranishëm në rastet pozitive me anë të teknikave klasike dhe të avancuara.
- 1.3. Kryerja e antibiogramës për të përcaktuar antibiotikët më efektivë sipas shkaqeve të izoluar bakteriale.
- 1.4. Vlerësimi i cilësisë dhe sigurisë së qumështit.
- 1.5. Vlerësimi zooteknik i gjendjes së tufës në fermat e qumështit.
- 1.6. Vlerësimi i ushqimeve dhe gjendjes së ushqyerjes në fermat e qumështit.
- 1.7. Analiza statistikore e të dhënave dhe prezantimi i rezultateve të fazës I.

Faza II: Testimi i Praktikave të Mira Veterinare (PMV) dhe i Praktikave të Mira Zooteknike (PMZ).

- 2.1. Përshtatja e PMV-ve dhe PMZ-ve për trajtimin e gjedhit të fermave të prekur nga mastiti.
- 2.2. Testimi i praktikave të mira veterinarë dhe zooteknike.
- 2.3. Testimi i fermave të gjedhit duke përdorur Testin Kalifornian të Mastitit (TKM).
- 2.4. Vlerësimi i cilësisë dhe sigurisë së qumështit.
- 2.5. Vlerësimi zooteknik i gjendjes së tufës në fermat e qumështit.
- 2.6. Vlerësimi i ushqimeve dhe gjendjes së ushqyerjes në fermat e qumështit.
- 2.7. Vlerësimi ekonomik i fermave të qumështit.
- 2.8. Analiza statistikore e të dhënave dhe prezantimi i rezultateve të fazës II.

Faza III: Përgatitja e Manualit Praktik për “fletëpalosjen e fermerit” në lidhje me mastitin dhe trajnimi i veterinerëve të rretheve (12 trajnues).

- 3.1. Përshtatja e një Manuali Praktik lidhur me menaxhimin praktik për parandalimin dhe trajtimin e mastitit të lopët e qumështit.
- 3.2. Përshtatja e Fletëpalosjes së Fermerit në lidhje me mastitin të lopët e qumështit.
- 3.3. Trajnimi i 12 veterinerëve të rretheve (trajnuesit).

Të gjitha të dhënat në lidhje me projektin pilot do të mbeten konfidenciale deri në fund të projektit.

A) Angazhimet e AKVMB:

- Koordinimi i procesit në tërësi midis AKVMB - ISUV – UBT për zbatimin e suksesshëm të projektit pilot:
- Përzgjedhja e veterinerëve dhe vendosja e tyre në dispozicion për t'u bërë pjesë e trajnimeve në kuadër të projektit pilot.
- Përzgjedhja e fermave që do të jenë pjesë e projektit pilot.
- Marrja e të gjitha materialeve dhe koordinimi i dorëzimit pranë ISUV dhe ekspertëve (për të ruajtur kitet dhe reagentët në kushte optimale; dorëzimi i këtyre materialeve do të bëhet në të njëjtën ditë dhe në të njëjtin vend).
- Paraqitja pranë GIZ e dokumentit të dorëzimit tek ISUV dhe ekspertët.

B) Angazhimet e ISUV:

- Vendosja në dispozicion e një personi kontakti për GIZ dhe AKVMB, i cili do të jetë përgjegjës për të gjitha angazhimet.
- Marrja e të gjithë materialeve të nevojshme nga AKVMB për zbatimin e fazës I dhe fazës II të projektit.
- Pranimin e mostrave të qumështit nga veterinerët dhe analizimi i tyre.
- Vënia në dispozicion e pajisjeve dhe stafit për të kryer të gjitha analizat laboratorike në lidhje me projektin.
- Gjenerimi i dokumenteve të analizave dhe paraqitja e tyre pranë konsulentëve të GIZ.

C) Angazhimet e UBT:

- Vendosja në dispozicion e një personi kontakti për GIZ dhe AKVMB, i cili do të jetë përgjegjës për të gjitha angazhimet.
- Përgatitja (tharja, bluarja) e mostrave të ushqimit për analiza zooteknike duke përdorur metodën Weende.
- Përcaktimi i lëndës së thatë dhe mineraleve në total.
- Analiza e mostrave të ushqimit të koncentrateve me metodologjinë e Spektroskopisë së Rrezatimit të Shkurtër Infra të Kuq (NIRS).
- Gjenerimi i dokumenteve të analizave dhe paraqitja e tyre pranë konsulentëve të GIZ.

D) Angazhimet e GIZ

- Mbështetje për blerjen e artikujve të nevojshëm për zbatimin e studimit pilot, të kërkuar nga AKVMB.
- Mbështetje me ekspertizë për kryerjen e projektit pilot dhe trajnimin e veterinerëve.
- Propozimi i një liste të fermave për të zbatuar projektin pilot, të cilat janë pjesë e ndërhyrjeve të tjera në zinxhirin e vlerës së produkteve të bulmetit në kuadër të SRD.
- Mbështetje përmes ofrimit të infrastrukturës për trajnimet (vendi, ushqimi, kostot e transportit).
- Mbështetje për veterinerët përmes rimbursimit të kostove të transportit (rimbursim për km).
- Konsulentët e GIZ do t'i dorëzojnë rezultatet dhe manualët pranë AKVMB.

3. **Modalitetet e bashkëpunimit**

- 3.1 GIZ dhe AKVMB do të caktojnë secili nga një person kontakti, i cili do të jetë përgjegjës për të garantuar zbatimin efikas të projektit të përbashkët dhe për të mbështetur rrjedhën e komunikimit midis Partnerëve:

Për GIZ: Dr. Sonja Kurz, Drejtuese e Zyrës

Për SRD: Z. Mattia Wegmann, Menaxher i Programit

Për AKVMB: Z. Roland Meçaj, Drejtor i Përgjithshëm

Për ISUV: Z. Ilir Ajdini, Drejtor i Përgjithshëm

Për UBT: Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, Rektor

- 3.2 Partnerët do të ndajnë informacione dhe do të takohen rregullisht për t'u konsultuar mbi ecurinë e Bashkëpunimit:

Çdo çështje ose problem që lind gjatë zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta do të njoftohet siç duhet përmes emailëve dhe, nëse është e nevojshme, përmes takimeve të posaçme.

- 3.3 Secili Partner do të mbulojë kostot e veta që burojnë nga modalitetet e bashkëpunimit, siç përcaktohet më sipër.

4. Ndarja e njohurive, shkëmbimi i informacionit dhe i dokumenteve

- GIZ dhe AKVMB do të **nxisin shkëmbimin e njohurive**, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit dhe të dokumenteve për çështjet me interes të përbashkët.
- GIZ dhe AKVMB **do të lehtësojnë shkëmbimin e informacioneve** të ofruara në kuadër të këtij Memorandumi Mirëkuptimi për përdorimin e tyre të brendshëm.

5. Të drejtat e pronësisë intelektuale

- a. Për sa i përket **të drejtave të autorit**, AKVMB dhe GIZ do të respektojnë rregulloret e institucioneve përkatëse.

6. Kohëzgjatja

- a. Ky Memorandum Mirëkuptimi, edhe pse synon krijimin e një bashkëpunimi afatgjatë me qëllimin e monitorimit të rezultateve, hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij nga Palët dhe do të përfundojë më 5 dhjetor 2026.
- b. Me përfundimin e afatit të përcaktuar më sipër dhe/ose në rast se ka edhe një fazë të tretë të projektit të GIZ, përveç rastit kur ka kundërshtime nga Palët, mund të merret në konsideratë procesi i një marrëveshjeje tjetër bashkëpunimi ose të shtyhet kohëzgjatja e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

7. Natyra jodetyruese

Asgjë në këtë Memorandum Mirëkuptimi nuk duhet të kuptohet ose interpretohet si një e drejtë ose detyrim ligjor i Partnerëve ose si detyrim i Partnerëve nënshkrues për të lidhur përfundimisht ndonjë marrëveshje. Në veçanti, ky Memorandum Mirëkuptimi nuk kufizon në asnjë mënyrë asnjë prej Partnerëve nga ndjekja e aktiviteteve të ngjashme me iniciativën e tyre ose nga pjesëmarrja në aktivitete të ngjashme me agjenci, organizata dhe individë të tjerë publikë ose privatë dhe nuk do të ofrojë ekskluzivitet ndërmjet Partnerëve në fushën e asnjë bashkëpunimi, nuk përkrah një subjekt specifik, nuk gjeneron asnjë të drejtë mbi asnjë person dhe nuk krijon asnjë detyrim për asnjë palë të tretë.

8. Njoftimet dhe ndryshimet

Palët rezervojnë të drejtën për të bërë ndryshime ose modifikime ndaj këtij Memorandumi Mirëkuptimi sipas nevojës. Këto ndryshime do të dakordësohen bashkërisht dhe do të bëhen me shkrim tre muaj përpara, për çdo ndryshim që mund të ndikojë në zbatimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

Çdo ndryshim në këtë Memorandum Mirëkuptimi do të bëhet vetëm në bazë të dhënies së pëlqimit me shkrim nga Palët.

Këto ndryshime hyjnë në fuqi 1 (një) muaj pas njoftimit të dhënies së pëlqimit nga të dy Palët.

9. Zgjidhja

- a. Nëse një nga palët kërkon zgjidhjen e këtij Memorandumi Mirëkuptimi, **ajo do të njoftojë palën tjetër 3 (tre) muaj përpara datës së propozuar për zgjidhjen.**
- b. Zgjidhja nuk do të ndikojë në angazhimet e ndërmarra në mirëbesim më përpara.



implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

State Secretariat for Economic Affairs SECO


AKVMB
AUTORITETI PËR MARRËSIRATË E VETËKONTROLLIMIT DHE MARRËSIRATË E SHËTËZË

ISUV
Instituti i Sigurimit Ungjjeror dhe antarvendetar




Ky Memorandum Mirëkuptimi hartohet në tetë kopje, nga dy për secilën palë, një në anglisht dhe një në gjuhën shqipe.

(Vendi, Data) TR 29.07.24



Dr. Sonja Kurz

Drejtuese e Zyrës
Deutsche Gesellschaft für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



Mattia Wegmann

Menaxher Programi - SRD
Deutsche Gesellschaft für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

(Vendi, Data)

24/07/2024

Roland Mecaç

Drejtor i Përgjithshëm
Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe
Mbrotjtjes së Bimëve



Prof. Dr. Fatbardh Sallaku

Rektor
Universiteti Bujqësor i Tiranës

Ilir Ajdini

Drejtor i Përgjithshëm
Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe
Veterinarisë